



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC**

Numri i lëndës: 2022:113988

Datë: 17.04.2024

Numri i dokumentit: 05584724

PPP.nr.03/2024

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Berkan Hamza, me bashkëpunëtoren profesionale Adelina Çmega, në çështjen juridike të përmbarrimit, sipas propozimit për përmbarrim të kreditores së përmbarrimit Gj me seli në Gjakovë, të paraqitur kundër debitorit të përmbarrimit A.K nga fshati Xërxë, Komuna e Rahovecit, për përmbarrimin e dokumentit të besueshëm – ekstraktit nga librat e kontabilitetit, për shkak të detyrimit në të holla në shumën prej 825.88 euro, në emër të shpenzimeve komunale për furnizim me ujë të pijshëm, lejuar me urdhrin për përmbarrim, P.nr.214/22 të datës 04.05.2022, të përmbarruesit privat Gj.R nga Gjakova, duke vendosur sipas prapësimit të debitorit të përmbarrimit, pas seancës dëgjimore të mbajtur më datën 02.04.2024, merr këtë:

**A K T V E N D I M**

REFUZOHET i pabazuar prapësimi i debitorit të përmbarrimit A.K nga fshati Xërxë, Komuna e Rahovecit, ushtruar kundër urdhrin për përmbarrim, P.nr.214/22 të datës 04.05.2022 të përmbarruesit privat, Gj.R nga Gjakova dhe mbetet në fuqi i njëjti urdhër për përmbarrim.

**A r s y e t i m**

Organi i përmbarrimit, përmbarruesi privat Gj.R nga Gjakova, me urdhrin për përmbarrim, P.nr.214/22 të datës 04.05.2022, ka lejuar propozimin për përmbarrim të kreditores së përmbarrimit, Gj me seli në Gjakovë, të paraqitur kundër debitorit të përmbarrimit A.K nga fshati Xërxë, Komuna e Rahovecit, për përmbarrimin e dokumentit të besueshëm – ekstraktit nga librat e kontabilitetit, për shkak të detyrimit në të holla në shumën prej 825.88 euro, në emër të shpenzimeve komunale për furnizim me ujë të pijshëm.

Kundër këtij urdhri për përmbarrim, pas pranimit të tij, debitori A.K ka ushtruar prapësim, më gjerësisht si në arsyetimin e këtij prapësimi, ndërsa pas pranimit të prapësimit nga pala kreditore Gj., ka parashtruar përgjigje në prapësim, më gjerësisht si në përgjigjen në prapësim.

Lidhur me këtë çështje përmbare, kjo gjykatë ka vendosur me Aktvendimin PPP.nr.40/2022, të datës 16.08.2023, e ka refuzuar prapësimin e debitorit të përmbaremit A.K, të ushtruar kundër urdhrorit për përmbare, P.nr.214/22 të datës 04.05.2022 të përmbaremit privat, Gj.R nga Gjakova, si dhe të njëjtin urdhër e ka lënë në fuqi.

Gjykata e shkallës së dytë me Aktvendimin C.A.P.nr.1425/2023 të datës 20.12.2023 e ka prishur vendimin e shkallës së parë dhe çështjen e ka kthyer në rivendosje. Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas rekomandimeve të gjykatës së shkallës së dytë ka mbajtur senac dëgjimore kryesor, në të cilin kanë prezentuar palët ndërgjyqëse.

Përfaqësuesi i autorizuar i kreditorës M.Z, në seancën dëgjimore ka deklaruar: Mbetet në tërësi pranë propozimit për përmbare të datës 04.05.2022, duke theksuar se borxhin e kërkon në bazë të dokumentit të besueshme - ekstraktit nga librat e kontabilitetit, të evidentuar në emër të A.K, me numër 008947, si dhe deklarimeve dhe theksimeve në pergjigjen në prapësim, të dorëzuar te përmbaremit privat me datë 20.05.2022. Duke shtuar se nga shkresat e lëndës vërtetohet fakti se debitori në rastin konkret e ka bërë pranimin e borxhit bazuar në deklaratën e nënshkruar në mes të debitorit dhe kreditorës, të datës 26.07.2021. Gjykatës i ka propozuar që ta refuzoj në tërësi prapësimin e debitorit.

Debitori A.K, në seancën dëgjimore ka deklaruar: Mbetet në tërësi pranë deklarimeve të cilat i ka bërë në prapësim, si dhe në ankesë. Duke shtuar se borxhi si i tillë është parashkruar, ndërsa nuk ka nuk e ka programuar një borxh të tillë dhe as nuk e ka paguar ndonjë borxh të programuar, por pagesat kanë qenë për shpenzime të ujit dhe asesi nuk kanë qenë të specifikuar në emër të kështit. Gjykatës i ka propozuar që ta anuloj urdhërin përmbaremit.

Sa i përket dokumentit përmbaremit, gjykata erdhi në përfundim se kreditorja e përmbaremit, propozimin për përmbare e ka bërë sipas dokumentit të besueshëm - ekstraktit nga librat e kontabilitetit, për shkak të detyrimit në të holla në shumën prej 825.88 euro, në emër të shpenzimeve për furnizim me ujë të pijshëm. Pra, dokumenti mbi të cilin pala kreditorja e mbështet propozimin për përmbaremit përbën dokument të besueshëm, në përputhje me nenin 29 par. 1 nën par. 2 të LPP-së, sipas të cilës dispozitë ligjore shprehimisht theksohet se *“Përmbaremit me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është: 1.2. ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave”*.

Gjykata me analizimin dhe shikimin e deklaratës për pranimin e borxhit e borxhit, të datës 26.07.2021, të nënshkruar nga kreditorja dhe debitori, ka vërtetuar faktin se debitori A.K e ka pranuar borxhin ndaj kreditorës dhe atë në shumën prej 818.77 euro.

Kështu, në nenin 360 par. 1 pika 1.1. të LMD-së, përcaktohet që *“kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat*

*shtëpiake, parashkruhen pas një (1) viti*". Mirëpo, është me rëndësi të theksohet se në nenin 368 të LMD-së parashihet që *"parashkrimi ndërpritet kur debitori e pranon borxhin. Pranimi i borxhit mund të bëhet jo vetëm me deklaratën e kreditorit, veçse edhe në mënyrë të tërthortë, sikurse janë pagesa e këstit, pagesa e kamatës, dhënia e sigurimit"*. Në rastin konkret, në bazë të deklaratës për pranimin e borxhit, të datës 26.07.2021, të nënshkruar nga kreditorja dhe debitori, gjykata ka vërtetuar faktin se debitori A.K e ka pranuar borxhin ndaj kreditores në shumë prej 818.77 euro, andaj me këtë veprim e ka ndërprerë aftin e parashkrimit.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, me vetë faktin e pagesave të kryera nga debitori i përmbarimit tek kreditori i përmbarimit dhe pranimin të borxhit nga debitori, është ndërprerë afati e parashkrimit, prandaj gjykata ka vendosur ta refuzojë në tërësi prapësimin e debitorit të përmbarimit.

Prandaj nga ajo që u theksua më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, në kuptim të nenit 3, 5, 21, 29, 37, 40, 69, 71, 73, 77 dhe nenit 78 të LPP-së lidhur me nenin 9 dhe 12 të Ligjit nr. 05/L-118 të datës 18.04.2018 për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit nr.04/L-139 të datës 20.12.2012 të LPP-së si dhe lidhur me nenin 65, 360 dhe 368 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) nr. 04/L-077.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC**

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil

PPP.nr.03/2024 më datë 02.04.2023

Bashkëpunëtorja profesionale  
Adelina Çmega

Gjyqtari  
Berkan Hamza

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese, brenda afatit prej 7 (shtatë) ditëve, pas ditës së pranimin të tij, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmes kësaj Gjykate Themelore.